

Raporti i Monitorimit RAP në Kosovë Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

2024/2025



Group for Legal
and Political
Studies



Publikimi:

**Raporti i Monitorimit RAP në Kosovë
Shërbimi Publik Dhe Menaxhimi I Burimeve Njerëzore
2024/2025**

Publikuesi:

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

Autorët:

**Blerina Istrefi,
Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë
Elona Kurti,
Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë**

Dizajni:

2vo

Contents:

I.	Rreth Weber 3.0	4
II.	Falënderime	5
III.	Përmbledhje Ekzekutive	6
IV.	Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve	8
V.	WeBER RAP Monitor: Çfarë monitorojmë dhe si?	9
I.1	Qasja e WeBER-it në monitorimin e RAP	9
I.2	Pse dhe si WeBER monitoron fushën “Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”	10
VI.	Transparencë, Qasje e Hapur dhe Meritokraci në Shërbimin Civil dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	16
II.1	Transparenca e statistikave dhe raporteve në shërbimin civil	16
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?	18
II.2	Transparenca e punësimit të përkohshëm në shërbimin civil	21
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?	22
II.3	Transparenca dhe parimi i meritës në procesin e rekrutimit	25
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?	27
II.4	Përzgjedhja e bazuar në meritë dhe mbrojtja e menaxherëve të lartë nga ndikimi i paligjshëm politik	30
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?	32
II.5	Transparenca dhe qartësia e informacionit mbi pagat në shërbimin civil	34
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?	35
VII.	Krahasimi i rezultateve të përgjithshme në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	37
II.6	Rekomandimet për Shërbimet Publike dhe Menaxhimin të Burimeve Njerëzore	38
II.6.1	Monitorimi i rekomandimeve të RAP 2021/2022	38
II.6.2	Rekomandimet nga raporti i monitorimit 2024/2025	40
VIII.	Shtojca e Metodologjisë	41
IX.	Lista e Burimeve të Referencuara në këtë Raport	48

Rreth Weber 3.0

Duke u mbështetur në arritjet e projekteve paraprake WeBER (2015–2018) dhe WeBER 2.0 (2019–2023), projekti Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 është granti i tretë radhazi i financuar nga Bashkimi Evropian i iniciativës më të madhe të udhëhequr nga shoqëria civile për monitorimin e reformës së administratës publike (RAP) në Ballkanin Perëndimor. Periudha e zbatimit të projektit është nga shkurti 2023 deri në korrik 2026. Të udhëhequr nga Parimet e SIGMA/OECD, dy fazat e para të iniciativës hodhën themelet për ambicien e WeBER 3.0 për të fuqizuar më tej organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që të kontribuojnë në administrata më transparente, më të hapura, më të përgjegjshme, të orientuara drejt qytetarëve dhe, rrjedhimisht, më të harmonizuara me standardet e Bashkimit Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

WeBER 3.0 vazhdon të promovojë rolin thelbësor të OSHC-ve në RAP, duke avokuar njëkohësisht për përfshirje më të gjerë të qytetarëve në këtë proces dhe për masa reformuese gjithëpërfshirëse, të përshtatura sipas nevojave të përdoruesve, të cilat çojnë në përmirësime konkrete. Duke i mbështetur veprimet në të dhëna dhe analiza të qëndrueshme monitoruese, WeBER 3.0 do të fuqizojë shoqërinë civile që të ndikojë më efektivisht në hartimin dhe zbatimin e RAP. Për të nxitur hartimin bashkëpunues të politikave dhe për të kapërcyer hendekun ndërmjet aspiratave dhe zgjidhjeve të zbatueshme, projekti do të lehtësojë dialog të qëndrueshëm politik ndërmjet qeverive dhe OSHC-ve përmes Platformës WeBER dhe Grupeve Kombëtare të Punës për RAP. Së fundmi, përmes granteve të vogla për OSHC-të lokale, WeBER 3.0 forcon angazhimin në nivel lokal në RAP, duke fuqizuar zërat e qytetarëve – përfituesit përfundimtarë të punës së administratave publike.

Produktet e WeBER 3.0 dhe informacione të mëtejshme rreth tyre janë të disponueshme në faqen zyrtare të projektit në adresën www.par-monitor.org.

WeBER 3.0 zbatohet nga Think for Europe Network (TEN), i përbërë nga gjashtë institute kërkimore (think tanks) të orientuara drejt politikave të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Përmes partneritetit me Qendrën për Kërkime në Administratën Publike (Centre for Public Administration Research – KDZ) nga Vjena, WeBER 3.0 ka siguruar dukshmëri në nivel të Bashkimit Evropian.

Falënderime

Ashtu si në edicionet e mëparshme të raporteve kombëtare të Monitorimit të RAP, të publikuara për periudhat 2017/2018, 2019/2020 dhe 2021/2022, falënderime të veçanta u drejtohen anëtarëve të Platformës WeBER dhe Grupit Kombëtar të Punës në Kosovë, si dhe palëve të tjera të interesit në Kosovë që ndanë përvojat e tyre përmes intervistave, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në cilësinë e këtij raporti. Për të mbrojtur anonimitetin e tyre, ata nuk janë identifikuar individualisht në këtë raport.

Ekipi i WeBER 3.0 dëshiron gjithashtu të falënderojë partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë, të cilët kanë mbështetur projektin në hulumtim dhe aktivitete të tjera. Në veçanti, këtu përfshihen SIGMA/OECD (Support for Improvement in Governance and Management),¹ ReSPA (Regional School of Public Administration), si dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e bashkëpunëtorëve të projektit.

¹ Një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe OECD-së.

Përmbledhje Ekzekutive

Vlerësimi i transparencës, qasjes së hapur dhe meritokracisë në shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore fokusohet në pesë aspekte kyçe - 1) transparenca e statistikave dhe raporteve për shërbimin civil; 2) transparenca e punësimit të përkohshëm në shërbimin civil; 3) transparenca dhe parimi i meritës në procesin e rekrutimit; 4) përzgjedhja mbi bazë merite dhe mbrojtja e menaxherëve të lartë nga ndikimi politik i padrejtë; dhe 5) transparenca dhe qartësia e informacionit mbi pagat në shërbimin civil. Aspekti i parë shqyrton disponueshmërinë e statistikave apo raporteve që mbulojnë strukturën e shërbimit civil dhe elementet kryesore të politikave të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Aspekti që i kushtohet punësimit të përkohshëm fokusohet në kushtet dhe kufizimet për këtë lloj punësimi, duke shqyrtuar njëkohësisht zbatimin e parimit të meritës, si dhe qasjen e hapur dhe transparencën e procedurës së punësimit.

Aspekti që i kushtohet procesit të rekrutimit fokusohet në qasshmërinë e shpalljeve të vendeve të lira të punës, ekzistencën e barrës administrative, mundësitë e barabarta për kandidatët e jashtëm gjatë procesit të aplikimit, mbështetjen institucionale për aplikantët, transparencën e rezultateve, si dhe perceptimin e qytetarëve mbi meritokracinë e rekrutimit. Sa i përket menaxherëve të lartë në shërbimin civil, theksi vihet në natyrën meritore të praktikave të rekrutimit dhe emërimit, si dhe në përdorimin e kriterëve objektive për shkarkim, kufizimet lidhur me emërimet në detyrë (ushtrues detyre), shkallën në të cilën emërimet mbrohen nga ndikimi politik në praktikë, si dhe konkurrueshmërinë e procedurave. Së fundmi, aspekti i fundit i kushtohet transparencës dhe qartësisë së sistemit të pagave në shërbimin civil, si dhe ekzistencës së prezantimeve të përshtatshme dhe të kuptueshme për qytetarët mbi elementet kryesore të këtij sistemi. Gjetjet e këtij raporti pasqyrojnë periudhën që nga publikimi i Monitorit RAP 2021/2022, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2022 dhe deri në fund të vitit 2024.²

Transparenca, qasja e hapur dhe meritokracia në shërbimin civil të Kosovës janë të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe strategjik, por zbatimi i tyre në praktikë mbetet i paqëndrueshëm. Meritokracia, në veçanti, trajtohet më shumë si një ideal dhe parim i përgjithshëm sesa si një kërkesë ligjore detyruese. Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2022–2027 dhe Ligji për Zyrtarët Publik (LZP) parashikojnë rritjen e qasjes së hapur përmes publikimit të të dhënave për pagat dhe zhvillimit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). Megjithatë, transparenca në statistika dhe raportim mbetet e kufizuar, me boshllëqe të mëdha ndërmjet detyrimeve ligjore dhe praktikës

² Për vitin 2022, përfshihen vetëm zhvillimet që nuk janë përfshirë në RAP Monitor 2021/2022.

aktuale. Institucionet shpesh dështojnë të publikojnë informata të plota dhe të besueshme.

Procedurat e rekrutimit në përgjithësi ndjekin parimet e meritës dhe menaxhohen përmes SIMBNJ. Megjithatë, shtrirja e informimit dhe qasja në të dhëna mbeten të kufizuara. Korniza ligjore që rregullon punësimin e përkohshëm, përmes Ligjit për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjore përkatëse, garanton që procedurat e rekrutimit të bazuara në meritë të jenë mekanizmi i vetëm i punësimit për stafin me kontratë afatshkurtër. Në anën tjetër, stafi i kontraktuar angazhohet në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, përmes kontratave për shërbime të veçanta dhe si i tillë nuk konsiderohet “personel” i shërbimit civil. Të dhënat e analizuara tregojnë se stafi i përkohshëm përbën vetëm një pjesë të vogël të fuqisë punëtore. Megjithatë, përfaqësuesit e shoqërisë civile vlerësojnë se ky sistem ka mangësi, pasi vlerësimi i kandidatëve nuk është gjithmonë i qëndrueshëm dhe i standardizuar, duke krijuar hapësirë për keqpërdorim të këtyre pozitave.

Emërimet në menaxhmentin e lartë rregullohen mbi bazën e parimit të meritës, por mungon mbledhja e centralizuar e të dhënave për pozitat ushtruese të detyrës. Kandidatët vlerësohen përmes provimeve me shkrim dhe me gojë, ndërsa emërimet zakonisht bëhen nga tre kandidatët me performancën më të lartë. Emërimet ushtruese të detyrës në shërbimin civil janë të kufizuara me ligj në maksimum dymbëdhjetë muaj; megjithatë, mungesa e statistikave e pengon monitorimin efektiv të këtij kufizimi. Kjo dobëson llogaridhënien dhe krijon hapësirë të mundshme për ndikim të padrejtë politik.

Sistemi i pagave, i rregulluar nga Ligji për Pagat në Sektorin Publik, ofron një strukturë ligjore për paga të drejta dhe transparente, duke përcaktuar koeficientët dhe pozitat në shërbimin civil. Megjithatë, edhe në këtë fushë ekziston një mospërputhje ndërmjet kuadrit ligjor dhe zbatimit praktik, i cili karakterizohet nga mungesë qartësie dhe transparence. Të dhënat mbi pagat nuk janë lehtësisht të qasshme për publikun, ndërsa rregullat për shtesat në pagë mbeten të paqarta.

Në përgjithësi, shërbimi civil i Kosovës është i ndërtuar mbi dispozita ligjore dhe strategjike që synojnë të sigurojnë transparencë, meritokraci dhe llogaridhënie. Megjithatë, ai mbetet joefikas³ dhe boshllëqet në zbatim vazhdojnë të jenë të pranishme në të gjitha fushat, që nga publikimi i të dhënave deri te emërimet në menaxhmentin e lartë. Publikimi i të dhënave statistikore për shërbimin civil me qëllim rritjen e transparencës, zhvillimi i mëtejshëm i SIMBNJ për të mbyllur boshllëqet ekzistuese, si dhe përmirësimi i cilësisë së testimit janë disa nga rekomandimet afatshkurtra dhe afatmesme të këtij raporti monitorues. Rekomandimet afatgjata përfshijnë avancimin e mëtejshëm të procesit të klasifikimit të vendeve të punës, zbatimin e plotë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe kufizimin e përdorimit dhe kohëzgjatjes së emërimeve ushtruese të detyrës.

3 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2024.

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

SHPMBJ – Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
SIMBNj – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
IZP – Ligji për Zyrtarët Publik
QDP – Qasja në Dokumente Publike (Liria e Informimit)
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
IK – Informatorë Kyç
RAP – Reforma e Administratës Publike
ReSPA – Shkolla Rajonale e Administratës Publike
SIGMA – Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
TEN – Rrjeti “Think for Europe”
WeBER – Projekti për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor
për Monitorimin e Reformës së Administratës Publike
DMZP – Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme
MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
ME – Ministria e Ekonomisë
MD – Ministria e Drejtësisë
MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

WeBER RAP Monitor: Çfarë monitorojmë dhe si?

I.1 Qasja e WeBER-it në monitorimin e RAP

Metodologjia e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP Monitor) është zhvilluar gjatë viteve 2015–2016, si pjesë e Projektit të parë “Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform” (WeBER). Që nga fillimi, WeBER ka adoptuar një qasje thellësisht të bazuar në dëshmi, me synimin për të rritur rëndësinë, pjesëmarrjen dhe kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor për të avokuar dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e Reformës së Administratës Publike. Metodologjia RAP Monitor përbën një produkt kyç të WeBER-it, duke mundësuar monitorimin e Reformës së Administratës Publike nga shoqëria civile, të bazuar në fakte dhe analiza.

Në përputhje me fokusin e WeBER-it në procesin e anëtarësimit të rajonit në Bashkimin Evropian, pas rishikimit të Parimeve të SIGMA-s për Administratën Publike në vitin 2023, metodologjia e WeBER RAP Monitor është ridizajnuar gjithashtu në vitin 2024. Ky rishikim është ndërtuar mbi Parimet⁴ e SIGMA-s dhe Metodologjinë e SIGMA-s,⁵ duke plotësuar monitorimin nga SIGMA-s përmes ofrimit të vëzhgimeve shtesë të përqendruara në transparencë, përfshirje, qasje të hapur dhe aspekte të tjera të funksionimit të administratave shtetërore, në varësi të fushës përkatëse të Reformës së Administratës Publike (RAP). Ky rishikim ndihmon në ruajtjen e fokusit të rekomandimeve të WeBER-it në reformat në përputhje me standardet e BE-së, duke i orientuar qeveritë e rajonit drejt një procesi të suksesshëm të anëtarësimit në BE dhe anëtarësimit të ardhshëm. Ndryshimet kryesore në metodologjinë e rishikuar të RAP Monitor paraqiten shkurtimisht më poshtë.⁶

Tabela 1. Ndryshimet kryesore në Metodologjinë e Monitorimit të RAP

Struktura

Për të qenë në përputhje me qasjen e re metodologjike të SIGMA-s, janë prezantuar ndryshimet strukturore në vijim:

- Prezantimi i një indikatorit të vetëm për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP), i ndarë në nën-indikatorë, të cilët përbëhen më tej nga disa elemente të nën-indikatorëve (p.sh. kritere specifike që vlerësohen), me qëllim thjeshtësimin e qasjes dhe theksimin e fokusit në transparencë, gjithëpërfshirje dhe qasje të hapur në secilën fushë të RAP-it.

4 OECD (2023), Principi i Administratës Publike, OECD Publikimi, Paris, <https://doi.org/10.1787/7f5ec453-en>.

5 I disponueshëm në: <https://www.sigmaxweb.org/en/publications/documents/2024/assessment-methodology-of-the-principles-of-public-administration.html>.

6 Për informacione të detajuara mbi fushëveprimin dhe procesin e rishikimit të metodologjisë, ju lutemi vizitoni: <https://www.par-monitor.org/par-monitor-methodology/>.

- Prezantimi i llojeve të elementeve të nën-indikatorëve, duke siguruar që të mbulohen të gjitha aspektet e reformës, si në vijim:
 1. Strategjia dhe politikat,
 2. Legjislacioni,
 3. Struktura institucionale,
 4. Praktika në zbatim, dhe
 5. Rezultatet dhe ndikimi.
- Prezantimi i një shkalle vlerësimi me 100 pikë, për një vlerësim më të detajuar të progresit në secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP).

Burimi i të dhënave

- Prezantimi i intervistave me “informatorë kyç”, përkatësisht akterë kryesorë jo-shtetërorë të angazhuar dhe të njohur me proceset. Këto intervista shërbejnë si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, duke zëvendësuar anketën e mëparshme me organizatat e shoqërisë civile.
- Përdorimi më sistematik i rezultateve të anketave të perceptimit publik si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, si dhe zgjerimi i fushëveprimit të anketës për të plotësuar vlerësimin në pesë fusha të Reformës së Administratës Publike (RAP), me përjashtim të fushës “Strategjia për RAP”.
- Heqja e anketës me nëpunësit civil si burim i të dhënave, për shkak të problemeve të vazhdueshme në sigurimin e shkallëve adekuate të përgjigjes në administratat e rajonit.

Raportimi i Monitorimit RAP

- Gjashtë raporte kombëtare të RAP Monitor, nga një për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP) (36 gjithsej për tërë ciklin e RAP Monitor), me qëllim lehtësimin e publikimit në kohë dhe avokimit për rezultatet e monitorimit, në vend që të publikohen rezultatet e 18 muajve hulumtim në fund të procesit.
- Gjashtë raporte rajonale përmbledhëse për Ballkanin Perëndimor, nga një për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP) (6 gjithsej).

1.2 Pse dhe si WeBER monitoron fushën “Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”

Një shërbim civil profesional, transparent dhe i bazuar në meritë përbën themelin e një administrate publike që vepron në interes të qytetarëve. Këto parime janë thelbësore për ruajtjen e profesionalizmit, integritetit dhe besimit publik në institucione. Monitorimi i WeBER-it fokusohet në mënyrën se si këto parime zbatohen në praktikë, përtej asaj që garantohet formalisht në ligje dhe strategji: duke filluar nga qasja dhe gjithëpërfshirja në shpalljet e vendeve të lira të punës, te transparenca e rezultateve të rekrutimit dhe qasja publike në të dhëna për aspektet kyçe të shërbimit civil. Këto çështje ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, reagimin dhe besueshmërinë e institucioneve publike. Kur rekrutimi politizohet, rregullat janë të paqarta ose të dhënat mbahen të

fshehura, qytetarët përballen me një administratë që u shërben interesave politike dhe jo nevojave publike. Monitorimi i kësaj fushe mbështet avokimin e bazuar në prova për një shërbim civil më kompetent, më llogaridhënës dhe të depolitizuar – një shërbim të cilit qytetarët mund t'i besojnë për të vepruar në interes të përgjithshëm.

Monitorimi në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazohet në katër Parime të SIGMA-s për këtë fushë:


Parimi 8: Korniza e punësimit siguron balancë ndërmjet stabilitetit dhe fleksibilitetit, garanton llogaridhënien e nëpunësve publik dhe i mbron ata nga ndikimet e padrejta dhe largimet e paligjshme nga puna.

Parimi 9: Administrata publike tërheq dhe rekruton persona kompetentë mbi bazën e meritës dhe mundësive të barabarta.

Parimi 10: Udhëheqja efektive nxitet përmes kompetencës, stabilitetit, autonomisë profesionale dhe përgjegjshmërisë së menaxhmentit të lartë llogaridhënës.

Parimi 11: Nëpunësit publik janë të motivuar, paguhën në mënyrë të drejtë dhe konkurruese dhe kanë kushte të mira pune.

Këto Parime vlerësohen nga perspektiva e disponueshmërisë së të gjitha informatave relevante për fusha të ndryshme kyçe të shërbimit civil, duke shqyrtuar njëkohësisht shkallën në të cilën rekrutimi i bazuar në meritë është i pranishëm në sistem, përfshirë procedurat për punësim të përkohshëm dhe emërimin e menaxhmentit të lartë mbi bazë të meritës. Fokusi në transparencë dhe qasje të hapur synon të përcaktojë masën në të cilën autoritetet përkatëse publikojnë informata që i ndihmojnë publikut të interesuar të krijojnë një pasqyrë mbi aspektet kyçe të sistemit, si dhe shkallën në të cilën shërbimi civil është i hapur për kandidatë të jashtëm gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj.



Periudha e monitorimit për fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përfshin zhvillimet që nga cikli i fundit i RAP Monitor, i cili zgjati nga janari deri në nëntor 2022. Rrjedhimisht, ky raport fokusohet kryesisht në vitet 2023 dhe 2024, si dhe në zhvillimet e fundit të vitit 2022 që nuk janë përfshirë në ciklin e mëparshëm. Megjithatë raporti ofron krahasim të gjetjeve me edicionet e mëparshme të RAP Monitor, pikët e vendeve nuk janë të krahasueshme me monitorimet e mëparshme për shkak të ndryshimeve metodologjike.

Sub- indikator i parë fokusohet në ekzistencën e statistikave dhe raporteve që mbulojnë të dhëna të rëndësishme dhe fusha kyçe të politikave të sistemit të shërbimit civil (siç janë rekrutimi, zhvillimi i karrierës dhe të ngjashme). Monitorimi i aspekteve të strategjisë dhe politikave, legjislacionit dhe praktikës në zbatim realizohet përmes kombinimit të analizës cilësore të dokumenteve strategjike, akteve nënligjore dhe të dhënave zyrtare të disponueshme publikisht. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tre intervista me informatorë kyç nga akterë jo-shtetërorë, të cilët kanë ekspertizë të konsiderueshme në këtë fushë dhe/ose përvojë direkte në pjesëmarrje në proceset e analizuara.

Tabela 2. Elementet e indikatorit në kuadër të sub- indikatorit 1

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 1.1 Kuadri strategjik parasheh përmirësime në transparencën e informatave bazë për shërbimin civil.	Strategji dhe Politikë
E 1.2 Aktet nënligjore përcaktojnë që të dhënat mbi shërbimin civil dhe të punësuarit në administratën shtetërore qendrore janë të qasshme për publikun.	Legjislacion
E 1.3 Qeveria publikon rregullisht raporte që lidhen me shërbimin civil	Praktika në zbatim
E 1.4 Raportet e publikuara përfshijnë të dhëna edhe për të punësuarit e tjerë, përveç nëpunësve civil, në administratën shtetërore qendrore	Praktika në zbatim
E 1.5 Raportet e publikuara i ndajnë të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit	Praktika në zbatim
E 1.6 Të dhënat për shërbimin civil janë të disponueshme në formate të hapura	Praktika në zbatim
E 1.7 Qeveria raporton në mënyrë gjithëpërfshirëse për elementet kyçe të politikave të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore	Praktika në zbatim
E 1.8 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë i vlerësojnë raportet për politikat e shërbimit civil si transparente dhe gjithëpërfshirëse	Praktika në zbatim

Sub- indikator i dytë vlerëson qasjen e hapur dhe transparencën e punësimit të përkohshëm në shërbimin civil, duke shqyrtuar njëkohësisht zbatimin e parimit të meritës dhe kufizimet në përdorimin e punësimit të përkohshëm.

Monitorimi i këtij nën-indikator bazohet në shqyrtimin e akteve nënligjore dhe faqeve zyrtare të institucioneve përkatëse, si dhe në dokumente zyrtare dhe të

dhëna të siguruara përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Vlerësimi i elementeve të tipit “praktika në zbatim” realizohet mbi një mostër të konkurseve më të fundit të përfunduara për punësim të përkohshëm në pesë institucione të ndryshme të administratës shtetërore qendrore, përkatësisht: 5 procedura konkurruese për punësimin e nëpunësve civil me afat të caktuar (nga një për secilin institucion) dhe 5 procedura konkurruese për punësimin e stafit të kontraktuar (nga një për secilin institucion), gjithsej 10 procedura të vëzhguara. Për vlerësimin e rezultateve dhe impaktit, hulumtuesit zhvillojnë intervista me informatorë kyç.

Tabela 3. Elementet e indikatorit në kuadër të sub- indikatorit 2

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 2.1 Aktet nënligjore përcaktojnë kushtet dhe kufizimet për punësimin e stafit të përkohshëm	Legjislacion
E 2.2 Aktet nënligjore përcaktojnë qasjen e hapur dhe zbatimin e parimit të meritës gjatë punësimit të stafit të përkohshëm	Legjislacion
E 2.3 Procedurat për punësimin e stafit të përkohshëm janë të hapura dhe transparente	Praktika në zbatim
E 2.4 Punësimet e përkohshme janë të kufizuara në praktikë	Praktika në zbatim
E 2.5 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë e vlerësojnë përdorimin e punësimit të përkohshëm si transparent, të kufizuar dhe me qëllim të arsyetuar	Rezultatet dhe ndikimi

Sub- indikator i tretë shqyrton transparencën e procesit të rekrutimit dhe zbatimin e parimit të meritës. Konkretisht, vlerësimi fokusohet në qasjen ndaj shpalljeve të vendeve të lira të punës, gjithëpërfshirjen dhe drejtësinë e procedurave për kandidatët e jashtëm, nivelin e mbështetjes institucionale për aplikantët dhe barrën administrative, si dhe disponueshmërinë e informatave mbi rezultatet e përzgjedhjes, përfshirë anulimin e procedurave.

Monitorimi i aspekteve të strategjisë dhe politikave, legjislacionit dhe praktikës në zbatim realizohet përmes kombinimit të burimeve të ndryshme të të dhënave, me qëllim maksimizimin e besueshmërisë së rezultateve. Ai përfshin analizë cilësore të dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe të dhënave zyrtare që janë publikisht të disponueshme ose që janë siguruar nga institucionet përgjegjëse përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Analiza e elementeve të tipit “praktika në zbatim” në kuadër të këtij nën-indikatorit realizohet në të njëjtat pesë ministri/institucione të administratës shtetërore qendrore që janë përfshirë në mostrën e nën-indikatorit 2. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tre intervista me informatorë kyç. Ndryshe nga dy nën-indikatorët e parë, për këtë nën-indikator përdoren gjithashtu edhe rezultatet e anketës së perceptimit publik për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit. Ankesa e perceptimit publik është realizuar posaçërisht për qëllimet e ciklit të RAP Monitor 2024/2025.

Tabela 4. Elementet e indikatorit në kuadër të sub- indikatorit 3

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 3.1 Kuadri strategjik parasheh përmirësime të qasjes së hapur, transparencës dhe zbatimit të parimit të meritës në procesin e rekrutimit.	Strategji dhe politikë
E 3.2 Aktet nënligjore përcaktojnë qasjen e hapur, transparencën dhe zbatimin e parimit të meritës në procesin e rekrutimit.	Legjislacion
E 3.3 Shpalljet e vendeve të lira të punës për konkursset publike bëhen gjerësisht të qasshme për publikun	Praktika në zbatim
E 3.4 Shpalljet e vendeve të lira të punës për konkursset publike prezantohen në mënyrë që të motivojnë dhe tërheqin kandidatët e jashtëm.	Praktika në zbatim
E 3.5 Institucioni përgjegjës ofron mbështetje dhe udhëzime për aplikantët.	Praktika në zbatim
E 3.6 Nuk ekzistojnë barrierat e paarsyeshme për kandidatët e jashtëm që do t'i bënin konkursset publike më të qasshme për kandidatët e brendshëm	Praktika në zbatim
E 3.7 Procedura e aplikimit imponon barrë minimale administrative/ dokumentare për kandidatët	Praktika në zbatim
E 3.8 Kandidatët mund të plotësojnë dokumentacionin e munguar brenda një afati të arsyeshëm kohor	Praktika në zbatim
E 3.9 Vendimet dhe arsyetimet e komisioneve përzgjedhëse bëhen publike, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale	Praktika në zbatim
E 3.10 Informacioni mbi konkursset publike të anuluar, përfshirë arsyetimin për anulim, bëhet publik	Praktika në zbatim
E 3.11 Informatorët kyç e vlerësojnë rekrutimin në shërbimin civil si transparent dhe të bazuar në meritë	Rezultati dhe ndikimi
E 3.12 Perceptimi i qytetarëve për rekrutimin në shërbimin civil të bazuar në meritë	Rezultati dhe ndikimi
E 3.13 Perceptimi i qytetarëve për ndikimin e lidhjeve personale në rekrutimin në shërbimin civil	Rezultati dhe ndikimi
E 3.14 Perceptimi i qytetarëve për ndikimin e lidhjeve politike në rekrutimin në shërbimin civil	Rezultati dhe ndikimi

Sub -indikator i katërt fokusohet në përzgjedhjen e bazuar në meritë të menaxherëve të lartë dhe në ekzistencën e mekanizmave për mbrojtjen e tyre nga ndikimi i padrejtë politik. Konkretisht, WeBER shqyrton nëse praktikën e rekrutimit dhe emërimit për menaxhmentin e lartë të shërbimit civil bazohen në meritë, duke analizuar kufizimet mbi emërimet në detyrë, përdorimin e kriterëve objektivë për shkarkim, si dhe shkallën në të cilën emërimet mbrohen nga ndikimi politik në praktikë.

Monitorimi mbështetet në shqyrtimin e strategjive dhe politikave, legjislacionit, uebfaqeve institucionale dhe dokumenteve zyrtare, të plotësuar me të dhëna të siguruara përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, të dërguara institucioneve përgjegjëse. Analiza e elementeve të tipit Praktikë në kuadër të këtij nën-indikator realizohet në të njëjtat pesë ministri/organe të administratës

qendrore shtetërore të përzgjedhura për nën-indikatorin 2. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë intervista me informatorë kyç, ndërsa të dhënat nga anketat e perceptimit publik nuk përdoren.

Tabela 5. Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 4

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 4.1 Kuadri strategjik parasheh forcimin e profesionalizmit të menaxhmentit të lartë të shërbimit civil.	Strategji dhe Politikë
E 4.2 Rregulloret parashohin procedura konkurruese dhe të bazuara në meritë për rekrutimin e menaxhmentit të lartë të shërbimit civil.	Legjislacion
E 4.3 Rregulloret parashohin që emërimet si ushtrues detyre në pozitat e menaxhmentit të lartë të bëhen vetëm nga brenda shërbimit civil dhe për një periudhë të kufizuar kohore.	Legjislacion
E 4.4 Rregulloret parashohin kriteret objektive për ndërprerjen e marrëdhënies së punës / shkarkimin nga pozitat e menaxhmentit të lartë.	Legjislacion
E 4.5 Ekzistenca e procedurave për emërimet në pozita të menaxhmentit të lartë jashtë fushëveprimit të legjislacionit të shërbimit civil.	Legjislacion
E 4.6 Rekrutimi i bazuar në meritë për pozitat e menaxhmentit të lartë zbatohet në praktikë.	Praktika në zbatim
E 4.7 Emërimet si ushtrues detyre, në praktikë, bëhen vetëm nga brenda shërbimit civil.	Praktika në zbatim
E 4.8 Raporti i kandidatëve të kualifikuar për nivelin e menaxhmentit të lartë.	Praktika në zbatim
E 4.9 Përqindja e emërimeve jo të bazuara në meritë në pozitat e menaxhmentit të lartë.	Praktika në zbatim
E 4.10 Aktorët kyç jo-shtetërorë vlerësojnë se procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të menaxherëve të lartë është i bazuar në meritë dhe se ata janë të mbrojtur nga ndikimi i paligjshëm politik.	Rezultati dhe ndikimi

Së fundi, sub-indikatorin 1 pestë shqyrton transparencën dhe qartësinë e sistemit të pagave në shërbimin civil, duke u fokusuar kryesisht në disponueshmërinë e informacionit mbi pagat dhe në nivelin e qasjes miqësore për qytetarët.

Monitorimi i këtij nën-indikatorit bazohet në shqyrtimin e rregulloreve dhe uebfaqeve të institucioneve përkatëse. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë intervista me informatorë kyç.

Tabela 6. Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 5

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 5.1 Rregulloret përcaktojnë një sistem pagash me strukturë të thjeshtë.	Legjislacion
E 5.2 Informacioni mbi sistemin e pagave në shërbimin civil është i disponueshëm online	Praktika në zbatim
E 5.3 Ekzistojnë shpjegime ose prezantime miqësore për qytetarët lidhur me informacionin mbi pagat.	Praktika në zbatim
E 5.4 Informatorët kyç vlerësojnë se informacioni mbi sistemin e pagave në shërbimin civil është transparent dhe i qartë.	Rezultati dhe ndikimi

II. Transparencë, Qasje e Hapur dhe Meritokraci në Shërbimin Civil dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Ky seksion paraqet rezultatet e vlerësimit për Kosovën. Çdo nën-seksion paraqet rezultatet për një nën-indikator (gjithsej pesë), duke filluar me një pasqyrë të shkurtër të zhvillimeve që nga RAP Monitor 2021/2022. Më pas vijon një vlerësim i detajuar i elementeve të nën-indikatorit, duke nisur nga politikat, legjislacioni dhe kuadri institucional, për të vazhduar me praktikën e zbatimit, dhe duke përfunduar me rezultatet dhe ndikimin. Çdo vlerësim i nën-indikatorit përmbyllet me grafikun që paraqet pikët e dhëna.

Grafiku më poshtë paraqet rezultatet e përgjithshme për fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Kosovë, të matur në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë.

Transparencë, qasje e hapur dhe meritokraci në shërbimin civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore



■ Të arritura ■ Jo të arritura

II.1 Transparenca e statistikave dhe raporteve në shërbimin civil

Parimi 8: Kuadri i punësimit balancon stabilitetin dhe fleksibilitetin, siguron llogaridhënie të nëpunësve publik dhe i mbron ata nga ndikimi i padrejtë dhe shkarkimi i paligjshëm.

Pikët e dhëna sipas elementeve në nën-indikatorin 1: Transparenca e statistikave dhe raporteve mbi shërbimin civil ⁷

Elementet e indikatorit	Lloji i elementit	Pikët
E 1.1 Korniza strategjike parasheh përmirësime në transparencën e informatave bazë mbi shërbimin civil.	Strategji dhe politika	0.5/0.5
E 1.2 Rregulloret parashohin që të dhënat mbi shërbimin civil dhe të punësuarit në administratën shtetërore qendrore të jenë publikisht të disponueshme.	Legjislacion	0.5/1
E 1.3 Qeveria publikon rregullisht raporte që kanë të bëjnë me shërbimin civil.	Praktika në zbatim	0/3
E 1.4 Raportet e publikuara përfshijnë të dhëna edhe për të punësuarit e tjerë, përveç nëpunësve civil, në administratën shtetërore qendrore.	Praktika në zbatim	0/3
E 1.5 Raportet e publikuara ndajnë të dhënat sipas gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit.	Praktika në zbatim	0/3
E 1.6 Të dhënat mbi shërbimin civil janë të disponueshme në format(e) të hapura.	Praktika në zbatim	0/3
E 1.7 Qeveria raporton në mënyrë gjithëpërfshirëse mbi elementet kyçe të politikës së shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.	Praktika në zbatim	0/3.5
E 1.8 Akterët kyç jo-shtetërorë vlerësojnë se raportet mbi politikat e shërbimit civil janë transparente dhe gjithëpërfshirëse.	Rezultati dhe ndikimi	0/2.5
Pikët totale për sub - indikatorin 1		1/19.5

Si pjesë e monitorimit të transparencës dhe publikimit të të dhënave në administratën publike, të gjeturat ofrojnë një pasqyrë të qartë si të planeve të parashikuara në dokumente, ashtu edhe të gjendjes reale në praktikë. Analiza fillon me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022–2027, e cila përcakton hapa konkretë për publikimin e të dhënave mbi pagat dhe ndërtimin e SIMBNJ. Më pas, shqyrtohen ligjet që përcaktojnë detyrimet për transparencë, për t'u ndalur më tej te mënyra se si institucionet, në praktikë, publikojnë raporte dhe të dhëna. Rezultatet tregojnë mospërputhje të qarta ndërmjet asaj që parashihet në strategji dhe ligje dhe asaj që zbatohet në realitet. Ky seksion përfshin gjithashtu edhe gjetje nga intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat ofrojnë njohuri shtesë mbi qasjen në shërbime, kapacitetet e institucioneve dhe cilësinë e të dhënave të vëna në dispozicion të publikut.

⁷ Nën-indikatorin 1 parë përqendrohet në nën-parimet vijuese të **SIGMA-s**: qeveria ka një politikë të qartë për shërbimin publik dhe përgjegjësi në nivel politik për këtë fushë është e përcaktuar; një organ qendror, me kompetenca të mjaftueshme, udhëheq dhe koordinon në mënyrë efektive sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) në shërbimin publik, ofron mbështetje për organet e administratës publike dhe monitoron zbatimin; organet e administratës publike kanë kapacitete të mjaftueshme për menaxhim profesional të burimeve njerëzore; një sistem informativ efektiv mbështet proceset e MBNJ-së dhe siguron të dhëna që mundësojnë hartimin e politikave të shërbimit publik të bazuara në prova.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?

Sub-indikatori 1: Transparenca e statistikave dhe raporteve mbi shërbimin civil (pikët maksimale 19.5 pikë)

Si pjesë e monitorimit të transparencës dhe publikimit të të dhënave në administratën publike, Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022–2027⁸ përfshin masa konkrete lidhur me publikimin e të dhënave mbi pagat në sektorin publik dhe zhvillimin SIMBNJ.⁹ Qëllimi kryesor i përcaktuar në këtë strategji është krijimi i një sistemi pagash transparent dhe të drejtë, i cili mund të tërheqë dhe mbajë profesionistë në shërbimin publik. Për arritjen e këtij qëllimi, plani parasheh klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me rregulloret përkatëse, ristrukturimin e pozitave në ministri deri në vitin 2026, si dhe publikimin vjetor të të dhënave mbi pagat e të punësuarve sipas kategorive dhe pozitave përmes SIMBNJ deri në vitin 2025.¹⁰ Për më tepër, strategjia parasheh zhvillimin dhe integrimin e moduleve të SIMBNJ me Thesarin, si dhe përgatitjen e analizave krahasuese të pagave me sektorin privat.¹¹ Këto masa tregojnë se kuadri strategjik e njeh qartë nevojën për transparencë dhe harmonizim të sistemit të pagave, ndonëse realizimi i tyre mbetet i varur nga zbatimi praktik nga institucionet përgjegjëse.

Nga perspektiva ligjore, korniza ekzistuese përcakton qartë detyrimin për publikimin e të dhënave mbi shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore. Ligji për Zyrtarët Publik, neni 13, paragrafi 1, pika 10,¹² i ngarkon Ministrisë së Punëve të Brendshme përgjegjësinë për përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. Ligji për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, neni 44, paragrafi 3,¹³ thekson parimin e transparencës dhe obligon agjencitë që të publikojnë dokumentet vjetore të performancës. Ndërkohë, Ligji për Statistikat Zyrtare, neni 5,¹⁴ obligon organet e administratës publike t'i sigurojnë Agjencisë së Statistikave të Kosovës qasje në informacionin që ato mbledhin dhe përpunojnë.

Megjithatë, pavarësisht këtyre dispozitave të përgjithshme për transparencë, ligjet nuk parashikojnë në mënyrë eksplicite detyrimin për publikimin e raporteve mbi shërbimin civil, duke krijuar kështu një boshllëk ligjor dhe duke e bërë këtë obligim më pak detyrues. Ligji tashmë i shfuqizuar nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik (që hyri në fuqi në mars 2019) përmbante dispozita të tilla, duke obliguar Njësitë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të përgatisnin raporte dhe t'i

8 I disponueshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/PUBLIC-ADMINISTRATION-REFORM-STRATEGY-2022-2027.pdf>

9 I disponueshëm në: <https://konkursi.rks-gov.net/>

10 Aksioni 3.3.1 and 3.3.3 në planin e veprimit 2025-2027 për PARS 2022-2027, I disponueshëm në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/5050/FINAL%20ANG%20PV%20SRAP%202025-2027%20pdf.pdf>.

11 Aksioni 3.3.5 për planin e veprimit 2025-2027 për PARS 2022-2027.

12 I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

13 I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684&langid=2>

14 I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2782>

dorëzonin ato të DMZP,¹⁵ e cila ishte përgjegjëse për hartimin dhe publikimin e raportit vjetor, si dhe për raportimin në Kuvend.¹⁶ Ky ligj u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në korrik 2020, për shkak se cenonte pavarësinë e institucioneve kushtetuese.¹⁷ Si pasojë, ligji aktual (që ka hyrë në fuqi në shtator 2023) nuk përfshin më dispozita që parashohin publikimin e raporteve të menaxhimit të burimeve njerëzore nga DMZP, duke lënë bazën ligjore të pjesshme dhe të paqartë sa i përket formës dhe afateve të publikimit.

Në praktikë, gjetjet e monitorimit tregojnë një situatë problematike. Për vitin 2023 nuk është publikuar asnjë raport mbi shërbimin civil, ndërsa kjo mungesë është evidentuar edhe për vitet paraprake. Edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar një plan të përgjithshëm të personelit për vitin 2024, ky dokument është bërë publik vetëm në muajin korrik, pra me vonesë të konsiderueshme, kur më shumë se gjysma e vitit kishte kaluar tashmë. Për më tepër, plani nuk ofron informacione të plota mbi numrin e nëpunësve civil sipas institucioneve, por fokusohet kryesisht në pozitat e lira. Kjo e bën raportimin të paplotë dhe jo në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe strategjike. Si rrjedhojë, vlerësimi për këtë element është negativ, pasi mungesa e raportit për vitin 2023 dhe kufizimet e qarta të planit të personelit për vitin 2024 tregojnë se transparenca në publikimin e të dhënave mbi shërbimin civil mbetet e pamjaftueshme.

Gjatë periudhës së monitorimit të kësaj fushe, nuk ka pasur raporte të publikuara apo statistika të disponueshme mbi shërbimin civil. Autoriteti qendror përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk i ka publikuar këto të dhëna për pesë vitet e fundit. Përmes një kërkesë për qasje në dokumente publike, është konfirmuar se aktualisht po bëhet grumbullimi dhe analiza e të dhënave nga institucionet qendrore dhe se, me mbështetjen e SIGMA-s, planifikohet publikimi i një raporti¹⁸ mbi shërbimin civil në të ardhmen. Ndërkohë, Ligji për Zyrtarët Publik, në nenin 5,¹⁹ përcakton kategoritë e zyrtarëve publik: nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësit e shërbimit publik, krijuesit dhe interpretuesit e artit dhe kulturës, stafin teknik dhe mbështetës, si dhe stafin e kabinetëve. Neni 6 parasheh gjithashtu një nënkategori të veçantë – nëpunësit civil me status të veçantë, ku përfshihen shërbimet korrektuese, shërbimi i jashtëm, agjencitë e aviacionit, mbrojtja, si dhe role të tjera të specializuara si policia dhe administrata tatimore.

15 Artikuli 14, para. 5 of Law No. 06/L-114 on Public Officials, I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>.

16 Artikuli 11.1.15 and Article 10.1.3 of Law No. 06/L-114 në Zyrtar Publik, I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>.

Institucionet e shqyrtuara ishin të njëjta me ato të përfshira në elementin 2.3, me përjashtim të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e cila u përdor në vend të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pasi kjo e fundit nuk kishte procedura të përfunduara. Të gjitha institucionet i kanë përmbushur me sukses të gjitha kriteret. Kandidatët janë testuar përmes testimeve me shkrim dhe me gojë. Testet me shkrim kanë përfshirë ese ose simulime, ndërsa testet me gojë kanë konsistuar në intervista të strukturuar. Kandidatët e emëruar kanë qenë të gjithë ndër tre performuesit më të mirë.

Sa i përket raportit të kandidatëve të kualifikuar për vendet e lira në menaxhmentin e lartë të shërbimit civil, monitorimi ka konstatuar se mesatarisht ka 5.5 kandidatë të kualifikuar për çdo vend të lirë, të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak, çka e tejkalon kriterin tonë minimal prej së paku 5.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës lejohet për një sërë arsyesh brenda kornizës ligjore. Rregullorja për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, në nenin 6, paragrafi 1, pika 3, parashikon se ndërprerja mund të ndodhë pas dy vlerësimeve negative të performancës.⁴⁸ Po ashtu, neni 5, paragrafi 1, pikat 2, 3 dhe 6, lejojnë ndërprerjen e marrëdhënies së punës për arsye të tilla si vendimi gjyqësor për vepër penale, humbja e shtetësisë ose paaftësia e përhershme për punë. Megjithatë, Rregullorja nuk përcakton nëse marrëdhënia e punës mund të përfundojë si pasojë e zvogëlimit të stafit. Një zyrtar i lartë civil i larguar gjatë riorganizimit duhet të sistemohen në një pozitë tjetër brenda gjashtë muajve dhe, nëse kjo nuk ndodh, pason largimi përfundimtar nga puna pas edhe gjashtë muajve shtesë. Ligji për Zyrtarët Publik, në nenin 57, trajton dhe rregullon masat disiplinore. Në paragrafin 2, pika 7, ai përcakton se për shkelje të rënda disiplinore, një nga masat e mundshme është largimi nga puna.

Nga intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile, dy të intervistuar shprehen në kundërshtim dhe një në pajtim me pohimin se përzgjedhja dhe emërimet bazohen në meritë. Ata theksojnë se ndikimi politik është i shpeshtë dhe se praktikat aktuale shpesh anashkalojnë vlerësimin e pavarur. Edhe pse ekzistojnë garanci ligjore, zbatimi i tyre mbetet i mangët. Përmirësimet e sugjeruara përfshijnë rishikimin e Ligjit për Zyrtarët Publik, forcimin e komisioneve të pavarura, përmirësimin e fazave të testimit me shkrim dhe intervistimit, si dhe sigurimin e pranisë së mekanizmave monitorues gjatë gjithë procesit. Të tre të intervistuarit nga shoqëria civile nuk pajtohen se menaxherët e lartë janë të mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga ndikimi i pajustificuar politik. Ata shtojnë se transparencë në emërimet është e paqëndrueshme dhe se mekanizmat mbrojtës kundër keqpërdorimeve, siç janë zgjatjet e pajustificuara të emërimeve në pozita ushtruese, shpesh anashkalojnë. Mekanizmat që synojnë parandalimin e presionit politik ekzistojnë në ligj, por në praktikë nuk janë mjaftueshëm të fortë, veçanërisht kur institucionet shfrytëzojnë boshllëqet ligjore për të emëruar ushtrues detyre në mënyrë të zgjatur ose të përsëritur.

48 I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=97876>.



II.5 Transparenca dhe qartësia e informacionit mbi pagat në shërbimin civil

Parimi 10: Nëpunësit publik janë të motivuar, paguhen në mënyrë të drejtë dhe konkurruese dhe kanë kushte të mira pune

Pikët e dhëna për secilin element në nën-treguesin 5: Transparenca dhe qartësia e informacionit mbi pagat në shërbimin civil ⁴⁹

Elementet e indikatorit	Loji i elementit	Pikët
E 5.1 Rregulloret përcaktojnë një sistem pagash me strukturë të thjeshtë	Legjislacion	1.25/1.5
E 5.2 Informacioni mbi sistemin e pagave në shërbimin civil është i qasshëm online	Praktika në zbatim	0/2
E 5.3 Ekzistojnë shpjegime ose prezantime miqësore për qytetarët lidhur me informacionin mbi pagat	Praktika në zbatim	0/2
E 5.4 Informatorët kyç e konsiderojnë informacionin mbi sistemin e pagave në shërbimin civil si transparent dhe të qartë	Rezultati dhe ndikimi	3.5/3.5
Total score for sub-indicator 5		4.75/9

⁴⁹ Nën-indikator i pestë përqendrohet në nën-parimet vijuese të SIGMA-s: administrata publike ofron një paketë konkurruese kompensimi financiar dhe jo-financiar—përfshirë pagat dhe përfitimet, mundësitë për zhvillim dhe karrierë, sigurinë në punë, si dhe një mjedis pune të respektueshëm dhe gjithëpërfshirës—me qëllim tërheqjen, motivimin dhe mbajtjen e punonjësve dhe ekipeve me aftësitë dhe kompetencat e kërkuara; sistemi i pagave është transparent për punonjësit dhe publikun, duke siguruar njëkohësisht një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje të të dhënave personale sensitive.

Sistemi i pagave në shërbimin civil në Kosovë rregullohet nga Ligji për Pagat në Sektorin Publik dhe rregulloret përkatëse, të cilat ofrojnë një kornizë të qëndrueshme ligjore për nivelet e pagave, koeficientët dhe shtesat. Ndërsa ligji formalisht garanton transparencë dhe qartësi, në praktikë të dyja mbeten të kufizuara. Boshllëqet kryesore përfshijnë mungesën e rregullave të qarta për kombinimin e shtesave, mungesën e informacionit publik për përdoruesit mbi pagat, si dhe komunikimin e dobët me qytetarët dhe nëpunësit civil. Intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile konfirmuan se, ndonëse sistemi është ligjërish i strukturuar mirë dhe synon të sigurojë drejtësi, transparenca dhe qartësia e tij në praktikë dobësohen nga zbatimi i paqëndrueshëm dhe mungesa e materialeve shpjeguese të qasshme. Përmirësime të tilla si publikimi i listave të detajuara të shtesave, zhvillimi i udhëzuesve publik dhe krijimi i një platforme digjitale për informacionin mbi pagat do të forconin transparencën, besimin dhe qasjen e barabartë.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?

Sub- indikatori 5: Transparenca dhe qartësia e informacionit në pagat e shërbimit civil (pikët maksimale 9)

Ligji nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik⁵⁰ është baza kryesore ligjore që rregullon këtë fushë. Nga faqja 20 e këtij ligji, të gjitha pozitat në shërbimin civil dhe nivelet e tyre paraqiten në formë tabele, duke përfshirë grupin, klasën, koeficientin dhe fushën e zbatimit. Për llogaritjen e pagës, neni 7, paragrafi 3 përcakton qartë formulën që përdoret. Shtesat përshkruhen në Kapitullin V të Ligjit, si dhe në Rregulloren 08/2023,⁵¹ ku ato paraqiten në përqindje, si dhe në Rregulloren 22/2024 për Ekspertët.⁵² Kushtet, kufijtë dhe kriteret për shtesat përcaktohen më tej përmes legjislacionit sekondar. Nenet 4 dhe 5 të Rregullores 08/2023 rregullojnë shtesat mbi bazën e performancës, duke përfshirë procedurën, kohën e zbatimit dhe autoritetin vendimmarrës. Megjithatë, ligji nuk përmban një rregull lidhur me kombinimin e shtesave, për shembull marrjen njëkohësisht të pagesës për orë shtesë dhe një shtesë mbi bazën e performancës. Për rrjedhojë, kombinimi i tyre as nuk është i rregulluar dhe as i ndaluar. Nga pesë kriteret e vlerësuara, katër janë përmbushur dhe një, ai që lidhet me kombinimin e shtesave, nuk është përmbushur. Pikët totale të dhëna janë 1.25.

Sa i përket transparencës së informacionit mbi pagat, vlerësimi ka treguar se nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që mund të vlerësohet pozitivisht. Ligji për Pagat, në faqen 20, paraqet një listë të gjatë të pozitave në shërbimin civil, nga më e larta deri te më e ulëta, së bashku me koeficientët përkatës, të cilët mund të përdoren për të llogaritur pagën e saktë. Ky informacion është publik, pasi është i përfshirë

50 I disponueshëm në: <https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Lawno.08-L-196-wqh6aKhPus.pdf>

51 I disponueshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-per-shtesat-e-te-punesuarve-ne-sektorin-publik.pdf>

52 Rregullorja nr. 22/2024 i ekspertëve, e disponueshme: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=96470>.

në ligj. Megjithatë, vetëm koeficienti nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar këtë element si pozitiv. Për këtë arsye, të gjitha kriteret janë shënuar me “Jo”: nuk ekziston informacion publik i përgjithshëm mbi pagat në të gjithë shërbimin civil (si paga mesatare, minimale apo maksimale); nuk ka ndarje të detajuara sipas pozitës apo gradës; nuk ofrohet informacion i qartë për pagat në shpalljet e vendeve të lira të punës; dhe nuk ka informacion mbi pagat të ndjeshme ndaj gjinisë apo të dhëna mbi hendekun gjinor të pagave. Pikët totale të dhëna janë 0.0.

Sa i përket qartësisë së sistemit të pagave dhe shpërblimeve për qytetarët, korniza ligjore ekziston dhe bazohet në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik,⁵³ e mbështetur nga Katalogu i Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Ligji për Ndarjet Buxhetore.⁵⁴ Këto dokumente janë të publikuara në Gazetën Zyrtare dhe janë të qasshme për publikun. Megjithatë, në praktikë vërehet mungesë e komunikimit të qartë dhe të strukturuar si me qytetarët ashtu edhe me nëpunësit civil, gjë që e bën sistemin më të vështirë për t’u kuptuar. Përmirësimet e sugjeruara përfshijnë publikimin e një liste të pozitive që përfitojnë shtesa, përgatitjen e materialeve informuese për publikun, si udhëzues të shkurtër dhe shpjegime praktike për strukturën e pagave dhe llogaritjen e shtesave, si dhe krijimin e një platforme digjitale ku çdo punonjës apo palë e interesuar mund të ketë qasje të qartë në informacionin mbi pagat dhe përfitimet. Kjo do të forconte transparencën, besimin dhe qasjen e barabartë në informacion. Megjithatë informacioni aktual nuk është miqësor për qytetarët, ky kriter është shënuar me “Jo” dhe pikët totale të dhëna janë 0.0.

Intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile janë zhvilluar gjithashtu për këtë tregues përfundimtar.⁵⁵ Sa i përket deklaratimit se sistemi i pagave në shërbimin civil është transparent, të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur “prirjen të pajtohen”. Sistemi bazohet në një kornizë të qartë ligjore, përfshirë Ligjin për Pagat, Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Katalogun e Vendeve të Punës – të gjitha të publikuara në Gazetën Zyrtare. Koeficientët e pagave dhe rregullat për shtesat janë të përcaktuara ligjërisht. Megjithatë, transparenca në praktikë mbetet e kufizuar, pasi mungojnë materialet shpjeguese, komunikimi me publikun dhe nëpunësit civil janë të paqëndrueshëm dhe listat e pozitive që përfitojnë shtesa nuk publikohen. Ndërsa sistemi është formalisht transparent, transparenca e tij praktike dobësohet nga mungesa e komunikimit të qartë dhe të qasshëm. Përmirësimet e sugjeruara përfshijnë publikimin e listave të detajuara të shtesave dhe krijimin e një platforme digjitale për transparencë të pagave.


Sa i përket deklaratimit se sistemi i pagave në shërbimin civil është i qartë, të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur sërish “prirjen të pajtohen”. Sistemi është ligjërish i strukturuar mirë dhe përcakton nivelet e pagave përmes koeficientëve të standardizuar, të bazuar në përgjegjësitë e pozitive. Qëllimi i tij është të sigurojë drejtësi dhe konsistencë ndërmjet institucioneve, duke reduktuar dallimet që

53 I disponueshëm në : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>.

54 Ligji për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>.


55 Intervistat janë zhvilluar nga 6 maji deri më 18 qershor 2025.

kanë ekzistuar më parë. Megjithatë, në praktikë, qartësia mbetet e kufizuar si për publikun ashtu edhe për disa nëpunës civil, për shkak të mungesës së shpjegimeve miqësore për përdoruesit. Sistemi i pagave gjithashtu nuk përditësohet rregullisht për të reflektuar inflacionin apo koston e jetesës, pasi nuk ekziston një mekanizëm indeksimi që i lidh pagat me ndryshimet ekonomike. Për më tepër, zbatimi i pagëndrueshëm dhe interpretimet e ndryshme ndërmjet institucioneve ndikojnë negativisht në qartësinë e sistemit. Për përmirësim, nevojiten më shumë materiale informuese për publikun dhe kanale të strukturuar komunikimi.



Krahasimi i rezultateve të përgjithshme në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Treguesi: Transparenca, hapja dhe meritokracia e shërbimeve civile dhe menaxhimit të burimeve njerëzore



Raporti i përgjithshëm rajonal në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me rezultatet për të gjitha administratat e BP është i qasshëm në: www.par-monitor.org

II.6 Rekomandimet për Shërbimet Publike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

II.6.1 Monitorimi i rekomandimeve i RAP 2021/2022

Rekomandimet	TLloji (afatshkurtër / afatmesëm / afatgjatë) ⁵⁶	Statusi	Përshkrimi
1. Ligji i ri duhet të amendamentohet dhe të harmonizohet me parimet e administratës publike të publikuara nga SIGMA/OECD dhe të kufizohet vetëm në ndryshimet e bazuara në udhëzimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në aktgjykimin nr. KO203/19 për LIGJIN NR. 06/L-114 PËR ZYRTARËT PUBLIK.	Afatgjatë	Implementuar pjesërisht	Ligji për Zyrtarët Publik është në fuqi dhe i harmonizuar me parimet bazë, por jo të gjitha rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese janë inkorporuar plotësisht.
2. Procesi i klasifikimit të vendeve të punës duhet të përfundohet për të mundësuar organizim të duhur të brendshëm dhe sistematizim të pozitive të punës, pranim të bazuar në kriterë objektive, si dhe përcaktimin e pagave të drejta dhe të sakta.	Afatshkurtë	Nuk është implementuar	Procesi i klasifikimit të vendeve të punës nuk është finalizuar dhe mbetet një prioritet i pazgjidhur në kuadër të reformave në vazhdim.
3. Procesi i rekrutimit të centralizuar dhe të bazuar në grupe për nivelin qendror duhet të zbatohet plotësisht dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.	Afatmesëm	Implementuar pjesërisht	Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përdoret për menaxhimin e rekrutimit, por mbikëqyrja e plotë qendrore dhe publikimi sistematik i rezultateve ende mungojnë.

⁵⁶ Recommendations for which the assessed time for implementation is up to one year are labelled as short-term. Medium-term recommendations should be implementable within a period of one to three years. Long-term recommendations require more than three years to be implemented.

4. SIMBNJ (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) duhet të zhvillohet vazhdimisht dhe zbatimi i tij praktik të përmirësohet përmes përditësimit të rregullt me të dhëna. Ky sistem duhet të mundësojë gjenerimin e statistikave të besueshme, në mënyrë që hartimi i politikave të bazohet në këto të dhëna.	Afatmesëm	Implementuar pjesërisht	SIMBNJ është funksional dhe pjesërisht i plotësuar me të dhëna nga institucionet, por përditësimi i rregullt dhe mbulimi i plotë i të dhënave ende mungojnë.
5. Ligji për pagat, me të gjitha mangësitë e identifikuara, duhet të zbatohet plotësisht përpara përfundimit të sistemit të klasifikimit të vendeve të punës në kategoritë ku kërkohet procesi i klasifikimit.	Afatgjatë	Implementuar pjesërisht	Ligji për Pagat është në fuqi, por zbatimi i tij përballet me mospërputhje dhe aplikim të pabarabartë ndërmjet institucioneve.
6. Të gjitha gabimet gjatë procesit të zbatimit të sistemit të ri të pagave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publik duhet të korrigjohen.	Afatmesëm	Nuk është implementuar	Çështjet e identifikuara gjatë zbatimit të Ligjit për Pagat nuk janë adresuar plotësisht; transparenca dhe komunikimi publik mbeten të kufizuara.

II.6.2 Rekomandimet nga raporti i monitorimit 2024/2025

Rekomandimet afatmesme

- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) duhet të fillojë publikimin e rregullt të raportit vjetor për shërbimin civil dhe burimet njerëzore, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit.
- MPB duhet të përmirësojë transparencën në rekrutim duke publikuar të gjitha rezultatet e konkurseve dhe arsyetimet e qarta për anulimet në platformën SIMBNJ.
- MPB duhet të forcojë mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit për të siguruar që të gjitha hapat të respektojnë parimin e meritës dhe të jenë të lira nga ndikimi politik.
- Institucionet qendrore duhet t'i bëjnë shpalljet e vendeve të lira më të dukshme dhe më tërheqëse për kandidatët e jashtëm, duke i publikuar ato gjerësisht dhe në gjuhë të qartë e të thjeshtë.

Rekomandimet afatmesme

- MPB duhet të vazhdojë zhvillimin e SIMBNJ dhe ta përditësojë rregullisht atë me të dhëna të sakta nga të gjitha institucionet, në mënyrë që statistikave të besueshme të përdoren për hartimin e politikave.
- MPB duhet të sigurojë që punësimi i përkohshëm të përdoret vetëm kur është i domosdoshëm dhe brenda kufijve ligjorë, përmes përmirësimit të monitorimit të kontratave me afat të caktuar dhe kontratave të shërbimit.
- MPB dhe Bordi i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të përmirësojnë cilësinë e testeve me shkrim dhe të intervistave, me qëllim që përzgjedhja e kandidatëve të jetë më objektive dhe profesionale.
- MPB duhet të përmirësojë komunikimin publik lidhur me sistemin e pagave, duke përgatitur udhëzues të shkurtër ose shpjegime që tregojnë qartë mënyrën e strukturimit të pagave dhe shtesave.

Rekomandimet afatgjata

- Qeveria e Kosovës duhet ta përfundojë procesin e klasifikimit të vendeve të punës për të siguruar organizim të qartë të pozitave dhe përcaktim të drejtë të pagave.
- Qeveria dhe MPB duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, duke korrigjuar të gjitha problemet e evidentuara gjatë fazës së parë të zbatimit.
- MPB duhet të sigurojë që emërimet ushtruese në pozita menaxheriale të bëhen vetëm brenda afateve ligjore dhe vetëm nga radhët e shërbyesve civil ekzistues, me qëllim parandalimin e keqpërdorimeve ose ndikimit politik.

Shtojca e Metodologjisë

Për hartimin e këtij raporti për Kosovën, janë përdorur metodat dhe mjetet vijuese të hulumtimit për mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e elementeve:

- Analiza e dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe uebfaqeve zyrtare
- Kërkesa për qasje të lirë në informata
- Intervista me palë të interesit dhe informatorët kyç
- Anketa e perceptimit publik

Monitorimi është mbështetur kryesisht në analizën e dokumenteve zyrtare të publikuara në uebfaqet e organeve të administratës dhe në të dhënat dhe informacionet e përfshira në to. Megjithatë, në rastet kur të dhënat nuk kanë qenë të qasshme, hulumtuesit kanë dërguar kërkesa për qasje të lirë në informata pranë institucioneve përkatëse, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për dhënien e pikëve për elementet.

Tabela X. Kërkesa për qasje në dokumente publike në Kosovë

Institucioni	Data e kërkesës	Data e përgjigjes ndaj kërkesës
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik	05.06.2025	10.06.2025
Ministria e Ekonomisë	05.06.2025	17.06.2025
Ministria e Edukimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	05.06.2025	13.06.2025
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	05.06.2025	25.06.2025
Ministria e Drejtësisë	05.06.2025	03.07.2025
Ministria e Punëve të Brendshme	05.06.2025	10.07.2025
Agjensia e Ushqimit dhe Vetërinarisë	11.08.2025	19.08.2025
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	11.08.2025	28.08.2025
Ministria e Drejtësisë	11.08.2025	26.08.2025
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	11.08.2025	13.08.2025
Ministria e Shëndësisë	11.08.2025	13.08.2025

Intervistat me informatorët kyç janë zhvilluar dhe janë përdorur si bazë për ndarjen e pikëve për elementet 1.8, 2.5, 3.11, 4.10 dhe 5.4. Përveç kësaj, ato janë shfrytëzuar për të mbledhur të dhëna cilësore, të fokusuara dhe të thelluara mbi fenomenet e monitoruara. Intervistat me palë të tjera të interesit (si përfaqësues të organeve të administratës publike) janë përdorur gjithashtu në hulumtim për të plotësuar dhe verifikuar të dhënat dhe gjetjet e mbledhura në mënyra të tjera. Përzgjedhja e të intervistuarve është bazuar në qëllime, joprobabilitar, duke synuar bashkëbisedues në bazë të ekspertizës së tyre në fushën përkatëse.

Intervistat me informatorët kyç janë përbërë nga një set prej deri në katër pyetjesh, ku pjesëmarrësit kanë shprehur nivelin e pajtimit të tyre në një shkallë me katër nivele: nuk pajtohem fare, prirem të mos pajtohem, prirem të pajtohem dhe pajtohem plotësisht. Pikët për elementet 1.8, 2.5, 3.11, 4.10 dhe 5.4 janë ndarë vetëm nëse të gjithë informatorët kyç kanë deklaruar se priren të pajtohen ose pajtohen plotësisht me deklaratën. Përveç kësaj, është përdorur edhe një set pyetjesh të hapura, të cilat kanë mundësuar diskutim me të intervistuarit dhe parashtrimin e pyetjeve shtesë gjatë intervistës, në vend të ndjekjes strikte të një formati të paracaktuar. Të intervistuarve u është garantuar anonimitet i plotë sa i përket të dhënave personale dhe përkatësisë institucionale apo organizative.

Tabela X. Intervistat e zhvilluara në Kosovë

Data	Intervistat
06.05.2025	Instituti për Zhvillimin e Politikave-INDEP
23.05.2025	Instituti GAP
18.06.2025	Grupi për Studime Juridike dhe Politike- GLPS

Lista e pyetjeve të Intervistës

► Elementi 1.8

Pyetjet në vijim përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 1.8. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të përgjigjeve “pajtohem plotësisht” ose “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjitha informatorët kyç shprehen se pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Raportet dhe statistikat mbi shërbimin civil që janë të qasshme publikisht janë transparente.**
 - a. pajtohem plotësisht
 - b. prirem të mos pajtohen
 - c. prirem të mos pajtohen
 - d. plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Raportet dhe statistikat mbi shërbimin civil që janë të qasshme publikisht janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse.**
 - a) pajtohem plotësisht
 - b) prirem të mos pajtohen
 - c) prirem të mos pajtohen
 - d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

Si do ta vlerësonit cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të publikuara në raportet zyrtare për shërbimin civil?

1. A munden qytetarët, mediat dhe shoqëria civile t'i gjejnë dhe t'i kuptojnë lehtë këto raporte?
2. A i mbulojnë raportet dhe statistikatat të gjitha aspektet relevante të shërbimit civil (si rekrutimi, promovimi dhe qarkullimi i stafit)?
3. A mungojnë ndonjë të dhëna kyçe në raportet publike për shërbimin civil? Nëse po, cilat janë ato?
4. Në çfarë mase përdoren të dhënat e publikuara për përmirësimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike?
5. Si do ta vlerësonit përdorshmërinë dhe strukturën e raporteve – a janë të dhënat të paraqitura qartë dhe të përshtatura për audienca të ndryshme?
6. A ka hapësirë për përmirësim në gjithëpërfshirjen dhe nivelin e detajimit të këtyre raporteve? Nëse po, si?

► Elementi 2.5

Pyetjet në vijim përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.5. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të përgjigjeve “pajtohem plotësisht” ose “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Përdorimi i punësimit të përkohshëm në shërbimin civil, si punësimi me afat të caktuar i nëpunësve civil dhe angazhimi i stafit me kontratë, është transparent.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Përdorimi i punësimit të përkohshëm në shërbimin civil, në praktikë, është i kufizuar.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem
3. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Përdorimi i punësimeve të përkohshme në shërbimin civil është i qëllimshëm.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem

Pyetjet shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve , por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Sipas mendimit tuaj, a ka informacion të mjaftueshëm publikisht të disponueshëm lidhur me punësimin e përkohshëm në shërbimin civil?
2. A ekzistojnë kritere dhe procedura të qarta për punësimin e nëpunësve civil të përkohshëm dhe stafit të kontraktuar?
3. A mendoni se procesi i përzgjedhjes për pozitat e përkohshme është i dokumentuar dhe i komunikuar në mënyrë adekuate me publikun?
4. Sipas mendimit tuaj, cilat janë problemet më të shpeshta në përdorimin e punësimit të përkohshëm në shërbimin civil?
5. Sipas mendimit tuaj, sa shpesh përdoren pozitat me afat të caktuar dhe pozitat e kontraktuara krahasuar me punësimin e përhershëm? A përdoren pozitat e përkohshme kryesisht për të adresuar nevoja afatshkurtra, apo ndodh që angazhimet e përkohshme të shndërrohen në role të përhershme?
6. A ka raste kur punësimi i përkohshëm përdoret përtej qëllimit të tij të synuar?
7. Çfarë masash, nëse ka, janë në vend për të parandaluar varësinë e tepruar nga stafi i përkohshëm në administratën publike?

► Elementi 3.11

Pyetjet në vijim përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.5. Ndarja e pikëve përcaktohet bazuar në përgjigjet “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Procesi i rekrutimit në shërbimin civil bazohet në meritë.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Procesi i rekrutimit në shërbimin civil është transparent.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. A mendoni se procesi i rekrutimit të bazuar në meritë në shërbimin civil zbatohet në mënyrë të qëndrueshme në praktikë?
2. A i konsideroni mekanizmat ekzistues për të siguruar që vendimet e rekrutimit bazohen në meritë si adekuate dhe me cilësi të mjaftueshme?

3. A ekzistojnë faktorë që e cenojnë rekrutimin e bazuar në meritë në shërbimin civil?
4. Sa transparente janë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes për rekrutimin në shërbimin civil?
5. A mendoni se kandidatët kanë qasje në informacion të qartë dhe të detajuar lidhur me shpalljet e vendeve të punës dhe proceset e përzgjedhjes?
6. Cilat janë sfidat kryesore për ta bërë rekrutimin në shërbimin civil plotësisht transparent dhe të bazuar në meritë?
7. Sa efektive janë mekanizmat e ankesave për kandidatët që besojnë se procesi i rekrutimit ka qenë i padrejtë?
8. Çfarë përmirësimesh mund të bëhen për të rritur njëkohësisht transparencën dhe meritokracinë në rekrutimin në shërbimin civil?

► Elementi 4.10

Pyetjet në vijim përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.5. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Menaxherët e lartë (nëpunësit e lartë civil) përzgjidhen dhe emërohen në bazë të meritës.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Menaxherët e lartë (nëpunësit e lartë civil) janë të mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga ndikimet e padrejta politike.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Si e vlerësoni procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të menaxherëve të lartë në shërbimin civil?
2. A besoni se përzgjedhja e nëpunësve të lartë civil bazohet në mënyrë të qëndrueshme në meritë dhe jo në konsiderata politike? Si mund të përmirësohet procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të menaxherëve të lartë për të siguruar vendimmarrje më të madhe të bazuar në meritë?
3. Çfarë mekanizmash mbrojtës ekzistojnë për të siguruar që menaxherët e lartë në shërbimin civil përzgjidhen në bazë të kualifikimeve dhe përvojës së tyre profesionale?

4. Sipas mendimit tuaj, a është sistemi aktual i emërimit të nëpunësve të lartë civil transparent dhe i drejtë?
5. Sipas mendimit tuaj, si do t'i vlerësonit mekanizmat për mbrojtjen e menaxherëve të lartë nga ndërhyrjet e padëshirueshme politike, nëse të tillë ekzistojnë?

► Elementi 5.4

Pyetjet në vijim përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.5. Ndarja e pikëve përcaktohet në bazë të përgjigjeve “plotësisht pajtohem” / “prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje për të cilën të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Sistemi i shpërblimit (pagave) në shërbimin civil është transparent.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem
2. Në çfarë mase pajtoheni me pohimin në vijim: **Sistemi i shpërblimit (pagave) në shërbimin civil është mjaftueshëm i qartë.**
 - a. a) nuk pajtohem aspak
 - b. b) prirem të mos pajtohem
 - c. c) prirem të pajtohem
 - d. d) plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Si do ta vlerësonit transparencën e sistemit të shpërblimit (pagave) në shërbimin civil?
2. A e konsideroni sistemin aktual të pagave në shërbimin civil të qartë? A janë kriteret për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve (bonuseve) të publikuara dhe lehtësisht të qasshme?
3. Si e vlerësoni drejtësinë e strukturës së pagave në shërbimin civil në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e pozitave të ndryshme?
4. Sipas mendimit tuaj, a përditësohet rregullisht sistemi i shpërblimit në shërbimin civil për të reflektuar ndryshimet në koston e jetesës apo faktorë të tjerë ekonomikë?
5. A ekzistojnë mekanizma për të siguruar që sistemi i pagave mbetet i barabartë dhe i drejtë ndërmjet niveleve të ndryshme të shërbimit civil?
6. Si komunikohet transparenca e sistemit të shpërblimit në shërbimin civil tek punonjësit aktualë dhe kandidatët potencialë?
7. A mendoni se publiku është i informuar në mënyrë adekuate lidhur me mënyrën se si strukturohen dhe ndahen pagat në shërbimin civil?
8. Çfarë përmirësimesh, nëse ka, do të sugjeronit për ta bërë sistemin e shpërblimit në shërbimin civil më transparent dhe më të qartë për të gjithë palët e interesuara?

Anketa e perceptimit publik bazohet në një pyetësor të adresuar për publikun e gjerë (banorë të përhershëm të Kosovës, 18+). Anketa është realizuar përmes intervistimit telefonik të asistuar me kompjuter (CATI), në kombinim me intervistimin online të asistuar me kompjuter (CAWI). Anketa është zhvilluar në periudhën 12–26 shkurt 2025. Marzhi i gabimit për kampionin prej 1,007 qytetarësh është $\pm 3,52\%$, me nivel besueshmërie prej 95%.

Tabela X: Pyetje të anketës së perceptimit publik në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Deklarata 2	Nuk pajtohem aspak	Prirë të mos pajtohem	Prirë të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di/Nuk kam opinion
Nëpunësit publik rekrutohen përmes konkurseve publike të bazuara në meritë (dmth. kandidatëve më të mirë u jepet mundësia të punësohen).	17.2	19.6	44.5	17	1.8
Deklarata 3	Nuk pajtohem aspak	Prirë të mos pajtohem	Prirë të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di/Nuk kam opinion
Për të siguruar një vend pune në administratën publike në vendin tim, nevojiten lidhje personale (dmth. lidhje familjare, farefisni, miqësi dhe të ngjashme).	11.3	20.4	39.9	27	1.5
Deklarata 4	Nuk pajtohem aspak	Prirë të mos pajtohem	Prirë të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di/Nuk kam opinion
Për të siguruar një vend pune në administratën publike, nevojiten lidhje politike (dmth. anëtarësimi në parti/organizata politike, ose lidhje personale me parti politike).	412.5	24.4	36.6	24.9	1.6

Lista e Burimeve të Referencuara në këtë Raport

Agjensia për Zhvillimin e Bujqësisë. 2025. Konkurs -Zyrtar për Autorizimin e Pagesave. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00017975>.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2023. Law No. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. Law No. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. Law No. 04/L-042 në Prokurimin Publik .

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2019. Law No. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2023. Law No. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. 18 September .

Komisioni Evropian. n.d. Kosovo 2024 Report.

Qeveria e Republikës së Kosovës. 2024. Regulation (GRK) No. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Afat të Caktuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës. 2023. Regulation (GRK) no. 08/2023 për shtesat në Sektorin Publik.

Qeveria e Republikës së Kosovës. 2023. Regulation (GRK) No. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Qeveria e Republikës së Kosovës. 2024. Regulation No. 29/2024 (GRK) për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

SIMBNJ. 2022. Si të aplikoni përmes platformës SIMBNJ. <https://www.youtube.com/watch?v=DyYfoH4XizE>.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. n.d. Si me apliku përmes platformës SIMBNJ. <https://konkursi.rks-gov.net/organisation-document-link>.

Agjensia e Statistikave të Kosovës. n.d. Anketa e Fuqisë Punëtore.

Ministria për Komunitete dhe Kthim. 2025. Konkurs - Zyrtar Administrativ. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00017983>.

Ministria e Ekonomisë. 2024. Konkurs- Sekreterar i Përgjithshëm. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014982>.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2024. Konkurs - Drejtor Ekzekutiv. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00015360>.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. 2025. Konkurs - Zyrtar i lartë për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00015360>.

rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00017048.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës. 2024. Konkursi - Zyrtar i Administratës. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00013795>.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. 2024. Konkursi - Drejtor Ekzekutiv. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00015255>.

Ministria e Punëve të Brendshme. 2024. Rishikimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Reformës së Administratës Publike.

Ministria e Punëve të Brendshme. 2025. Konkurs - Drejtor Ekzekutiv. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00017202>.

Ministria e Punëve të Brendshme. 2022. Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022 - 2027 .

Ministria e Drejtësisë; Shërbimi Korrektues i Kosovës. 2024. Konkurs - Zëvendës Drejtor Ekzekutiv për Trajtimimin e të Burgosurve. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00015423>.

Ministria e Zhvillimit Rajonal. 2024. Konkurs - Zyrtar për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Projekteve. <https://konkursi.rks-gov.net/advertisement/details?refNumber=RN00014041>.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. 2022. Rregullorja No.001/2022 në Prokurimin Publik.

2024. Rregullorja nr . 002/2024 për plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës No. 001/2022 në Prokurimin Publik.

SIGMA. 2023. Parimet e Administratës Publike. 6, Nëntor . https://www.sigmaweb.org/en/publications/2023/11/the-principles-of-public-administration_5e68f805.html.



Funded by
the European Union

With funding from
 Austrian
Development
Agency

Produced within Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 project. WeBER 3.0 is implemented by Think of Europe Network - TEN and Centre for Public Administration Research – KDZ.

WeBER 3.0 is funded by the European Union and the Austrian Development Agency - ADA. Views and opinions expressed are however those of the authors only and do not necessarily reflect those of the European Union or ADA. Neither the European Union, ADA, TEN nor KDZ can be held responsible for them.

For more information, please visit www.par-monitor.org.